

# RAPORT MONITORUES MBI DHUNËN NDAJ GRAVE NË POLITIKË

## ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

Tiranë, Maj 2023

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

***Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.***

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

***Autor: Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"***

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>5</b>
<b>2.</b>	<b>HYRJE .....</b>	<b>5</b>
<b>3.</b>	<b>KONTEKSTI I ZGJEDHJEVE VENDORE NË SHQIPËRI .....</b>	<b>6</b>
<b>4.</b>	<b>RËNDËSIA E MONITORIMIT TË DHUNËS NDAJ GRAVE NË POLITIKË GJATË ZGJEDHJEVE .....</b>	<b>7</b>
<b>5.</b>	<b>METODOLOGJIA .....</b>	<b>8</b>
5.1.	MONITORIMI DIREKT.....	9
5.2.	MONITORIMI I MEDIAVE SOCIALE.....	10
5.3.	PLATFORMA PËR DENONCIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE NË POLITIKE .....	11
5.4.	INTERVISTA ME GRA NË POLITIKE .....	12
5.5.	MONITORIMI NË 12 BASHKI TË VENDIT .....	12
<b>6.</b>	<b>ANALIZIMI I MONITORIMIT NGA AKTORË TË TJERË .....</b>	<b>13</b>
<b>7.</b>	<b>ANALIZA E GJETJEVE KRYESORE .....</b>	<b>16</b>
	DISKRIMINIMI NË PËRDORIMIN E MJETEVE TË FUSHATËS DHE BURIMEVE .....	16
	PROBLEMET DHE SFIDAT E GRAVE NË PJESËMARRJEN NË ZGJEDHJE: .....	16
<b>8.</b>	<b>KONKLUZIONE .....</b>	<b>17</b>
<b>9.</b>	<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>18</b>
<b>10.</b>	<b>REFERENCA .....</b>	<b>21</b>

**Shkurtime**

<b>AMA</b>	Autoriteti i Mediave Audiovizive
<b>GADC</b>	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
<b>KQZ</b>	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
<b>KZAZ</b>	Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor
<b>MVZ</b>	Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve
<b>OSBE OHIDR</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>Rrjeti POP</b>	Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”
<b>WFD</b>	Fondacioni Westminster për Demokraci

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Dhuna ndaj grave dhe vajzave në politikë është një çështje shqetësuese dhe e rëndësishme që kërkon veprime të menjëhershme dhe të vendosura për të adresuar problemin. Megjithëse nuk ka raportime të provuara për dhunën në politikë, është e vërtetë që ky fenomen ekziston dhe vazhdon të mbetet i fshehur, veçanërisht në rastet kur gra dhe vajza vendosin të angazhohen për poste drejtuese. Është e rëndësishme që partitë politike, institucionet shtetërore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti të angazhohen së bashku, për të siguruar që gratë dhe vajzat të përfshihen në politikë pa frikë, duke dhënë kontributin e tyre të vlefshëm. Gjithashtu është e nevojshme të kuptohet se raportimi i dhunës mund të jetë i vështirë për shkak të shumë faktorëve dhe prandaj është më e rëndësishme të kemi mekanizma të besueshëm për raportim, anonimitet dhe mbështetje për gratë dhe vajzat që përballen me dhunë dhe diskriminim. Analiza e zhvilluar në këtë raport tregon se:

- Nuk janë raportuar raste të dhunës ndaj grave në politikë gjatë fushatës zgjedhore. Pavarësisht nga forma e dhunës, si verbale, emocionale, apo të tjera, nuk janë vërejtur raste të dukshme gjatë kësaj periudhe zgjedhore.
- Është vërejtur diskriminim në përdorimin e mjeteve të fushatës dhe burimeve si: mungesa e financimit adekuat për fushatat e grave; mungesa e vizibilitetit në media lokale dhe ato kombëtare;
- Sipas monitorimit të Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim” por edhe bazuar në Deklaratën e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, nuk pati retorikë mizogjene, kërcënime apo gjuhë urrejtjeje drejtuar politikaneve gra, apo ngacmime online ndaj grave në kontekstin zgjedhor.
- Megjithëse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind për të gjitha organet e administrimit zgjedhor, vetëm tre nga 12 anëtarët e KQZ-së ishin gra, duke përfshirë edhe nënkombisionerin/en. Rreth 29 për qind e anëtarëve të KZAZ-së ishin gra, duke përfshirë 19 nga 92 kryetarët.
- Vetëm 15 nga 144 kandidatët për kryetar bashkie ishin gra. Edhe pse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind, gratë janë të nënpërfaqësura në të gjithë administratën zgjedhore, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse.

## 2. Hyrje

Qëllimi kryesor i raportit është analizimi i kontekstit politik dhe situatës së grave në politikën shqiptare përgjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023. Përmes metodave hulumtuese cilësore, analizimit statistikor të të dhënave ekzistuese, si dhe intervistave me gra politike, raporti ka për qëllim të prezantojë situatën aktuale dhe sfidat me të cilat përballen gratë në angazhimin e tyre aktiv në politikë.

Në bazë të kësaj analize, objektivi i raportit është të formulojë rekomandime konkrete për institucionet politike, partitë politike dhe shoqërinë civile për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe rolin e grave në politikë, duke adresuar pengesat dhe sfidat që ende ekzistojnë. Raporti synon të nxisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e barazisë gjinore në politikën shqiptare dhe të kontribuojë në zhvillimin e politikave dhe masave që promovojnë pjesëmarrjen aktive dhe të barabartë të grave në proceset politike. Në këtë mënyrë, raporti ka si qëllim të ndikojë në ndërgjegjësimin e opinionit publik, krijimin e hapësirave më të barabarta për gruan në politikë dhe zhvillimin e demokracisë dhe diversitetit gjinor në vendin tonë. Së fundmi, raporti parashtron rekomandime konkrete për të

adresuar dhe luftuar dhunën ndaj grave në politikën shqiptare. Duke u bazuar në analizën e problemit dhe arsyetimin e treguar. Ky raport sugjeron hapa të cilat mund të ndërrmerren nga institucionet shtetërore, partitë politike dhe shoqëria civile për të promovuar barazinë gjinore në politikë, për të përmirësuar mbështetjen dhe pjesëmarrjen e grave, si dhe për të hartuar politika dhe masa ligjore për parandalimin e dhunës gjinore dhe ndëshkimin e akteve të tilla. Rekomandimet synojnë të krijojnë një mjedis më të sigurtë dhe të barabartë për gratë që angazhohen në politikë, duke kontribuar në zhvillimin e një mjedisi demokratik me qasje në diversitetin gjinor në vendin tonë.

### 3. Konteksti i zgjedhjeve vendore në Shqipëri

Në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 në Shqipëri, një aspekt që kërkon vëmendje të veçantë është mungesa e rasteve të raportuara të dhunës ndaj grave në politikë. Ky raport synon të analizojë këtë situatë dhe të ofrojë një kuptim më të thelluar për mungesën e raportimeve dhe arsyt e mundshme të saj.

Për të kuptuar mungesën e raportimeve të dhunës ndaj grave në politikë, është e rëndësishme të analizojmë kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023. Periudha zgjedhore u karakterizua nga një angazhim i lartë i institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe komunitetit për të promovuar shancet e barabarta në procesin zgjedhor.

Zgjedhjet vendore të 14 majit u karakterizuan nga një pjesëmarrje e ulët e zgjedhësve në të gjitha zonat zgjedhore, ku Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) raportoi se vetëm 38.23% e zgjedhësve ishin paraqitur pranë qendrave të votimit.<sup>1</sup> Në përgjithësi procesi zgjedhor ishte i qetë dhe transparent, me disa vonesa në aspektet teknike.

Fushata elektorale e partive politike mbeti e polarizuar, ku liderët partiakë ishin më të angazhuar për të kryer fushatën në zonat zgjedhore sesa kryetarët e bashkive. Për këtë arsye, çështjet me rëndësi për komunitetin në zgjedhjet vendore kaluan në plan të dytë dhe fokusi u përqendrua në betejën politike ndërmjet forcave partiake dhe projekteve largpamëse.

Për sa i përket raportit gjinor në kandidaturat për kryetar bashkie, vetëm 15 nga 144 kandidatë ishin gra të përzgjedhura për të garuar në zgjedhje nga partitë politike, ku fituese në këto zgjedhje ishin 7 gra, respektivisht në bashkitë Dimal, Durrës, Klos, Kurbin, Lushnjë, Përmet dhe Roskovec. Ndërkohë që sa i përket kandidatëve fitues për Këshillat Bashkiakë, 677 ose 47% e Këshilltarëve janë gra.<sup>2</sup>

Edhe pse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind, gratë ishin të nënpërfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse. I njëjti fenomen u vërejt edhe gjatë administrimit zgjedhor, ku edhe pse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë prej 30% në të gjitha organet administrative, vetëm 3 nga 12 anëtarë të KQZ ishin gra<sup>3</sup>. Ndërkohë, rreth 29 për qind e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) ishin gra, duke përfshirë 19 nga 92 kryetarët.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KQZ faqja zyrtare: <https://iemis.kqz.gov.al/results2023/results2023.htm>

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> OSBE ODIHR Deklarata e Gjetjeve dhe Konkluziooneve Paraprake

[https://www.osce.org/files/f/documents/3/c/543570\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/3/c/543570_0.pdf)

<sup>4</sup> Po aty.

Gjatë zgjedhjeve Vendore të 14 Majit 2023, nuk pati ndonjë incident të dukshëm në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave në politikë. Gjithashtu nuk pati ndonjë informacion nga media për sulme seksiste dhe gjuhë urrejtje ndaj grave dhe vajzave kandidate apo edhe atyre në poste drejtuese si ministër apo tjetër.

Një nga faktorët kryesorë që mund të shpjegojnë mungesën e raportimeve të dhunës ndaj grave në politikë është rritja e ndërgjegjësimit pozitiv dhe forcimi i ligjeve për këtë çështje. Në vitet e fundit, ka pasur një përpjekje të vazhdueshme për të ngritur ndërgjegjësimin në shoqëri në lidhje me problemin e dhunës ndaj grave dhe për të promovuar barazinë gjinore në politikë. Trajnime dhe programe të ndërgjegjësimit kanë ofruar njohuri të nevojshme dhe strategji për parandalimin e dhunës në përgjithësi përfshirë atë ndaj grave në politikë. Përveç ndërgjegjësimit, ligjet dhe politikat kanë ndryshuar në mënyrë që të adresojnë më mirë problemin e dhunës ndaj grave: Neni 9 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon shprehimisht diskriminimin për shkak të gjinisë apo faktorëve të tjerë për sa i përket të drejtës së votës, të drejtës për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në poste publike, duke ofruar kështu një bazë ligjore për mbrojtje nga diskriminimi gjinor në politikë.<sup>5</sup> Gjithashtu, mbrojtje nga diskriminimi gjinor ofrohet edhe me anë të Ligjit për Barazinë Gjinore në Shoqëri.<sup>6</sup> Edhe pse nuk i referohen në mënyrë specifike gjinisë apo dhunës ndaj grave në politikë, nene të veçanta të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si neni 325 “Pengimi i subjekteve zgjedhore”, neni 329 “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, neni 330 “Pengimi i zgjedhësit”,<sup>7</sup> mund të përdoren për të adresuar këtë lloj dhune. Këto nene janë pjesë e një kreu të posaçëm për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve në Kodin Penal<sup>8</sup>. Gjithashtu, në listimin e rrethanave që rëndojnë dënimin për një vepër penale, neni 50 i Kodit Penal përfshin edhe motivet që kanë të bëjnë me gjininë.

Edhe pse ka një rritje domethënëse të ndërgjegjësimit, mungesa e raportimeve të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 mund të lidhet gjithashtu me frikën dhe pengesat që mund të kenë pasur gratë në politikë për të raportuar. Gratë mund të kenë pasur frikën e përshkallëzimit të dhunës, ndëshkimit, humbjes së reputacionit politik, ndikimit negativ në karrierë, stigmatizimit dhe mospërballimit të seriozitetit të rasteve të raportuara. Kjo frikë mund të jetë e bazuar në përvojat e mëparshme të grave të tjera në politikë që kanë hasur vështirësi dhe pengesa në raportimin e rasteve të dhunës.

Pavarësisht mungesës së raportimeve të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023, është e rëndësishme që të adresohet çështja e dhunës ndaj grave dhe vajzave në politikë dhe të përmirësohet situata aktuale.

#### **4. Rëndësia e monitorimit të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve**

Monitorimi i dhunës ndaj grave në politikë përgjatë zgjedhjeve vendore në Shqipëri, siç është rasti i zgjedhjeve të 14 majit 2023, ka një rëndësi të veçantë për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë, të lirë dhe demokratik. Dhuna ndaj grave në politikë është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe e barazisë gjinore dhe gjithashtu ka ndikim të madh në integritetin dhe legjitimitetin e një procesi zgjedhor.

---

<sup>5</sup> Ligji Nr. 10 221 datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (ndryshuar me ligjin nr.124/2020), neni 9

<sup>6</sup> Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”

<sup>7</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë: [Kodi Penal-1.pdf \(drejtesia.gov.al\)](#)

<sup>8</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Kreu X. [Kodi Penal-1.pdf \(drejtesia.gov.al\)](#)

Më poshtë renditen disa aspekte të rëndësishme të monitorimit të dhunës ndaj grave në këtë kontekst konkret:

- **Mbrojtja e të drejtave të njeriut:** Monitorimi i dhunës ndaj grave në politikë ndihmon në zbatimin e të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtën e grave për të marrë pjesë në jetën politike dhe për të qeverisur. Duke identifikuar dhe dokumentuar rastet e dhunës, mund të ndërmerren masa për t'i mbrojtur gratë dhe për të ndëshkuar ata që shkelin ligjin.
- **Përforsimi i barazisë gjinore:** Dhuna ndaj grave në politikë përkeqëson barazinë gjinore dhe pengon pjesëmarrjen aktive të grave në politikë. Monitorimi i dhunës ndaj grave ndihmon në zbulimin e parregullsive dhe në adresimin e tyre për të siguruar një barazi konkrete gjinore dhe një konkurrencë të ndershme politike ndërmjet dy gjinive.
- **Siguria dhe integriteti i zgjedhjeve:** Dhuna ndaj grave në politikë shkakton frikë, intimidim dhe ndikim të padrejtë në procesin zgjedhor. Monitorimi i dhunës ndaj grave ndihmon në identifikimin e zonave të rrezikshme dhe të praktikave të kundraligjshme, duke kontribuar në sigurinë dhe integritetin e zgjedhjeve.
- **Ndikimi në legjitimitetin e procesit zgjedhor:** Nëse dhuna ndaj grave në politikë lejohet të mbizotërojë, ajo çon në një mungesë besimi të përgjithshëm në procesin zgjedhor dhe në sistemin politik. Monitorimi i dhunës ndaj grave ndihmon në garantimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent, duke rritur besimin e qytetarëve në rezultatin e zgjedhjeve dhe legjitimitetin e organeve të zgjedhura.
- **Ndërtimi i një kulture politike të paqes dhe respektit:** Duke monitoruar dhe adresuar dhunën ndaj grave në politikë, mund të promovohet një kulturë politike e paqes, respektit dhe të drejtave të njeriut. Ky proces kontribuon në ndërtimin e një shoqërie të barabartë dhe të drejtë, ku gratë kanë një rol të barabartë me burrat në vendimmarrje politike.

Për të garantuar suksesin e monitorimit të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve në Shqipëri, është e rëndësishme që institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të angazhohen në një bashkëpunim të ngushtë dhe të përgjegjshëm për të zbuluar, dokumentuar dhe ndëshkuar rastet e dhunës ndaj grave, si dhe për të promovuar një kulturë politike të paqes, respektit dhe barazisë gjinore.

## 5. Metodologjia

GADC ka kryer monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 në Shqipëri. Për të identifikuar dhe dokumentuar rastet e dhunës ndaj grave në politikë, u përdorën disa mënyra sipas listimit vijues:

- **Monitorimi direkt** – Vëzhgimi i fushatës zgjedhore; mbledhja e të dhënave të tjera për dhunën ndaj grave në politikë.
- **Monitorimi i mediave sociale** – Monitorimi i mesazheve dhe postimeve në rrjetet sociale që janë të lidhura me zgjedhjet vendore dhe kandidatët.
- **Ndërtimi i platformës për raportimin e dhunës ndaj grave në politikë**  
<https://stopvawp.al/> një platformë e cila ofron dy mekanizma për raportimin e dhunës ndaj grave në politikë:
  - Raportimi duke plotësuar formularin anonim online
  - Raportimi me anë të telefonit në numrin jeshil pa pagesë 08001818
- **Intervista me gra të angazhuara në politikë.**



- **Monitorimi individual nga partnerë në 12 bashki të vendit**, anëtarë të Rrjetit POP<sup>9</sup> – Përballja e Ofertave Politike.<sup>10</sup>

## 5.1. Monitorimi direkt

Në përgjithësi, raporti i monitorimit nxjerr përfundimin se gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 në Shqipëri, përveç ndonjë rasti të titujve të lajmeve<sup>11</sup> nga portalet e ndryshme, të cilat shpesh nuk janë në përputhje me kontekstin, por përdoren për të tërhequr vëmendjen e lexuesit për të klikuar mbi lajmin<sup>12</sup>, nuk janë vërejtur raste të dhunës ndaj grave në politikë, pavarësisht nga forma e saj, si verbale, emocionale, apo tjetër. Ky monitorim i gjerë ka përfshirë vëzhgimin e aktiviteteve të kandidatëve politikë, debatet publike, fushatat elektorale dhe ndërveprimet e tyre me votuesit.

Disa prej televizioneve kryesore në vend të cilat u monitoruan: Radio Televizioni Shqiptar; Top Channel; Klan Tv; Vizion Plus; Euronews Albania; A2 News; ABC News; News 24 etj

Disa prej portaleve kryesore në vend të cilat u monitoruan: Agjencia Telegrafike Shqiptare; Shqiptarja.com; Syri.net; Politiko.al; Telegrafi.com; GazetaTema.net; Sot News; Zëri i Amerikës; Deutsche Welle në shqip etj.

Për më shumë se dy muaj monitorimi, Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” nuk ka raportuar raste të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur të dhëna të qarta për raste të dhunës të vërtetuara.

Ky rezultat mund të konsiderohet si një aspekt pozitiv i procesit zgjedhor. Është vlerësuar se rritja e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e barazisë gjinore dhe respektimin e të drejtave të grave ka përmirësuar ndërgjegjësimin e politikanëve dhe të qytetarëve në përgjithësi.

Në kuadër të vëzhgimit që GADC bëri gjatë zgjedhjeve u hartua një pyetësor online<sup>13</sup>, i cili i jepte mundësi kujtdo të raportonte një rast dhune ndaj grave e vajzave në politikë. Pyetësori u nda në të gjitha mediat sociale, faqen e internetit si edhe me anë të shpërndarjes me email duke ftuar qytetarët për tu angazhuar në raportime për dhunën ndaj grupit të synuar.

Duke krahasuar të dhënat e zgjedhjeve të mëparshme me ato të zgjedhjeve të fundit, vlerësohet se nuk ka raste dhune për grupin e synuar. Sondazhet dhe studimet e opinionit publik, mbështetën vlerësimin për rritjen e ndërgjegjësimit në përgjithësi. Po ashtu edhe organizata të tjera të shoqërisë civile<sup>14</sup> nuk raportuan raste të dhunës ndaj grave dhe vajzave në politikë.

---

<sup>9</sup> Faqe zyrtare <https://popnetwork.al/>

<sup>10</sup> Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxjerrur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare aktive në: Tiranë, Durrës; Fier; Vlorë; Kamëz; Kukës; Korçë; Shkodër; Pukë; Vau I Dejës; Elbasan; Pogradec.

<sup>11</sup> A2: <https://www.youtube.com/watch?v=wme2UpWQWEk>

<sup>12</sup> Balkan Web: <https://www.balkanweb.com/igli-cara-mund-te-jete-djali-i-mire-por-nuk-do-bejme-krushqi-rama-nga-durresi-po-te-jete-per-pastrues-merr-nje-grua/>

<sup>13</sup> Pyetësor Online: <https://stopvawp.al/formulari-online/>

<sup>14</sup> Organizatat e Shoqërisë Civile të përfshira në këtë hulumtim: Shoqata për Integrimin e Zonave Informale (SHIZI) – Kamëz; Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim (RIAS) – Pogradec; Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) – Durrës; Qendra Rinore “Epoka e Re” – Fier; Intelektualet e Rinj,

Sidoqoftë, në këtë kontekst, është e rëndësishme të vazhdohet puna për të forcuar ligjet dhe politikat që promovojnë barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave në politikë. Ndërgjegjësimi dhe edukimi duhet të jenë pjesë e proceseve zgjedhore dhe trajnimeve për kandidatët politikë dhe ata që angazhohen në politikë. Në të njëjtën kohë, duhet të zhvillohen mekanizma efektive për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të mundshme të dhunës ndaj grave në politikë, duke siguruar që gratë të kenë besim dhe mbështetje për të raportuar dhe për të marrë masa ligjore ndaj dhunuesve.

Periudha e monitorimit të situatës nëse do të kishte dhunë ndaj grave e vajzave në politikë hasi në disa sfida. Në kontekstin e mungesës së rasteve të raportuara, një nga shqetësimet kryesore është prania e frikës për të ballafaquar raste konkrete për shkak të perceptimit negativ social që gratë mund të ndeshin. Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit dhe forcimit të ligjeve, gratë mund të kenë heshtur për shkak të frikës së përndjekjes, stigmatizimit, apo humbjes së reputacionit në politikë. Është e rëndësishme të merren në konsideratë këto aspekte dhe të punohet për të krijuar një mjedis të sigurtë dhe mbështetës për gratë që ndeshen me dhunën në politikë, në mënyrë që ato të kenë guximin dhe mundësinë për të raportuar dhe për të kërkuar drejtësi. Partitë politike duhet të krijojnë mekanizma mbrojtës dhe nxitës të raportimit të dhunës nga gratë e vajzat në politikë e vendim marrje.

Në vijim të monitorimit, GADC do të vazhdojë të angazhohet në ndërgjegjësimin, trajnimin dhe mbështetjen e grave në politikë, si dhe në advokimin për politika dhe masa të mëtejshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave. Në bashkëpunim me institucionet relevante dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, GADC synon ndërtimin e një shoqërie të barabartë dhe të drejtë, ku të gjitha gratë të kenë mundësi të marrin pjesë në politikë pa frikë nga dhuna dhe shkelja e të drejtave të tyre.

## 5.2. Monitorimi i mediave sociale

Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat sociale në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë ofron një perspektivë të rëndësishme për të vlerësuar dhe analizuar ndikimin e kësaj çështjeje në platformat digjitale. Për të kuptuar më mirë këtë aspekt, u hartua një metodologji e strukturuar për të identifikuar fjalët kyçe, hashtags, emrat e kandidatëve politikë dhe çështjet e lidhura me dhunën ndaj grave në politikë. Kjo metodologji u përdor për të shqyrtuar postimet, komentet dhe pjesëmarrjen e përgjithshme në media sociale në lidhje me këtë temë. U monitoruan mediat kryesore që përdoren në Shqipëri si Facebook; Instagram dhe Twitter, megjithëse ky i fundit nuk ka një përdorim nga qytetarët gjerësisht. Fokusi kryesor ishte monitorimi i platformës Facebook, si platforma me 94.78% të përdoruesve në Shqipëri<sup>15</sup>

Pas përpunimit të të dhënave, u evidentuan disa aspekte të rëndësishme të monitorimit në mediat sociale:

1. **Identifikimi i diskursit:** Përmes analizës së postimeve, komenteve dhe përgjigjeve në media sociale, u identifikuan dhe u vlerësuan llojet e diskursit që lidheshin me dhunën

---

Shpresë (IRSH) – Shkodër; Qendra “Lëvizja Rinore për Demokraci” (LRD) – Pukë; Qendra për Progres Rinor – Kukës; Qendra Rinore – Vlorë; Tjeter Vizion – Elbasan; Gruaja ne Zhvillim – Korce; Hapa të Lehtë - Vau i Dejës

<sup>15</sup> Statcounter GlobalStats: <https://gs.statcounter.com/social-media-stats/all/albania>

ndaj grave në politikë. Kjo përfshinte diskutimet rreth rasteve të dhunës, opinionet e publikut, argumentet politike dhe propozimet për zgjidhje.

2. **Shpërndarja gjeografike:** Një aspekt tjetër i vlerësuar ishte shpërndarja gjeografike e postimeve dhe pjesëmarrja e përdoruesve në media sociale. Përmes analizës së të dhënave, u identifikuan zonat ku ndikimi i dhunës ndaj grave në politikë ishte më i lartë, duke siguruar një perceptim më të plotë të situatës.
3. **Tendenca dhe ndikimi:** Një analizë e thelluar u bë edhe për të vlerësuar tendencat dhe ndikimin e mediave sociale në perceptimin e dhunës ndaj grave në politikë. U analizuan faktorë si numri i postimeve, përqindja e reagimeve pozitive dhe negative, niveli i ndikimit dhe shpërndarjes së informacionit në rrjetet sociale.

Bazuar në monitorimin e fushatës zgjedhore në mediat sociale në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë, u konkludua se përveç disa rasteve të izoluara të diskutuara në media sociale (portale të pidentifikuara, që ndajnë lajme të rreme, disa prej të cilave nuk ekzistojnë më), nuk u evidentuan raste të dhunës ndaj grave në politikë, ashtu siç nuk u raportuan raste të tilla në monitorimin e përgjithshëm të fushatës zgjedhore.

Këto rezultate sugjerojnë se ndikimi i mediave sociale në perceptimin e dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 ishte relativisht i kufizuar. Megjithatë, është e rëndësishme të vazhdohet monitorimi dhe analiza e diskursit në media sociale, duke patur parasysh rëndësinë e këtij kanali informues për formimin e opinionit publik dhe ndikimin e tij në procesin zgjedhor.

### 5.3. Platforma për denoncimin e dhunës ndaj grave në politikë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i monitorimit të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 ishte ndërtimi dhe promovimi i faqes së internetit stopvawp.al. Kjo platformë u zhvillua me qëllim ofrimin e dy mekanizmave për raportimin e rasteve të dhunës ndaj grave në politikë. Këto mekanizma përfshinin:

- **Raportimin duke plotësuar formularin anonim online:** Përmes faqes së internetit një formular anonim <https://stopvawp.al/formulari-online/> ishte i disponueshëm ku mund të raportoheshin raste të dhunës në politikë. Kjo metodë raportimi u hartua me qëllim ofrimin e një rruge të sigurtë dhe konfidenciale për të shprehur përvojat e tyre dhe për të raportuar incidentet që mund të kishin përjetuar.
- **Raportimi me anë të telefonit në numrin jeshil pa pagesë 08001818:** Përveç formularit online, platforma stopvawp.al ofronte edhe një numër telefoni jeshil pa pagesë ku gratë mund të telefononin për të raportuar rastet e dhunës në politikë. Ky mekanizëm ofronte një mundësi të drejtpërdrejtë për të komunikuar dhe raportuar incidentet, duke siguruar një linjë të hapur për ndihmë dhe mbështetje për gratë në nevojë.

Kjo analizë sugjeron se, pavarësisht mungesës së raportimeve të rasteve të dhunës ndaj grave në politikë nëpërmjet platformës stopvawp.al, ka nevojë për një përqendrim të vazhdueshëm në rritjen e ndërgjegjësimit publik, rishikimin e ligjeve dhe politikave të ndërmarrja për të luftuar dhunën ndaj grave në politikë dhe ndikuar që gratë të mos stepen të raportojnë rastet e dhunës dhe diskriminimit në politikë. Një klimë e sigurtë dhe e mbrojtur për gratë në politikë duhet të jetë objektiv i gjithë shoqërisë shqiptare.

#### 5.4. Intervista me gra në politike

Në përpjekje për të mbledhur informacionin dhe për të analizuar nëse partitë politike kanë mekanizma për të parandaluar dhunën ndaj grave në politikë, u realizuan disa intervista me gra të përfshira në politikë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksojmë se rezultatet e nxjerra nga ky target grup i rëndësishëm nuk paraqesin një tablo informuese të mjaftueshme dhe konkrete lidhur me fenomenin e rasteve të dhunës në politikë.

Në këto intervista, pyetjet që u drejtuan ishin të fokusuar në perceptimin dhe përvojën e tyre në lidhje me dhunën në politikë, si dhe në ndikimin e saj në angazhimin e tyre politik dhe motivimin për të kandiduar. Megjithatë, pavarësisht diskutimeve të hapura dhe sfidave të identifikuara në fushën e politikës, gratë që morën pjesë në intervista nuk ndanë raste konkrete dhune apo dëshirën për të diskutuar më tej për këtë çështje.

Kjo situatë mund të ketë disa shpjegime të mundshme. Së pari, gratë përfaqësuese të partive politike, që morën pjesë në intervista mund të mos kenë përjetuar raste të dhunës ndaj tyre në politikë gjatë kohës së fushatave zgjedhore. Kjo mund të reflektojë një zhvillim pozitiv në procesin zgjedhor, ku mungesa e rasteve të dhunës ndaj grave në politikë mund të interpretohet si një tregues i përparimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik për respektimin e barazisë gjinore dhe ndalimin e dhunës në politikë. Së dyti, gratë kandidate mund të kenë patur frikë ose rezerva për të diskutuar apo denoncuar raste të dhunës në politikë. Dhuna ndaj grave në politikë vazhdon të jetë një çështje delikate dhe komplekse, e cila shpesh shoqërohet me stigma, kritikë dhe vështirësi për të mbështetur dhe adresuar rastet. Në këtë kontekst, gratë kandidate mund të kenë pasur arsye për të mos ndarë eksperiencat e tyre të dhunës në politikë duke zgjedhur të heshtin në përgjigjet e tyre rreth kësaj problematike.

Ky monitorim dhe mungesa e raportimeve nuk do të thotë që nuk ka dhunë ndaj grave e vajzave në politikë në Shqipëri. Ndaj është shumë e rëndësishme të angazhohemi në ngritjen e ndërgjegjësimit publik, forcimin e ligjeve dhe politikave për të luftuar dhunën ndaj grave në politikë dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe më të mbrojtur për to. Gjithashtu, duhet punuar më shumë për të adresuar frikën dhe pengesat që mund të kenë gratë për të raportuar dhe denoncuar rastet e dhunës. Vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe të vazhdueshme mund të ndërtohet një shoqëri ku gratë kanë një rol aktiv dhe të barabartë në proceset politike, pa frikë nga dhuna dhe shkeljet e të drejtave të tyre.

#### 5.5. Monitorimi në 12 bashki të vendit

Metoda tjetër që u përdor për monitorimin e dhunës ndaj grave në politikë, gjatë zgejdhjeve vendore Maj 2023, ishte monitorimi individual nga partnerët e GADC në 12 bashki të vendit. Partnerët janë anëtarë të Rrjetit POP - Përballja e Ofertave Politike<sup>16</sup>, organizata të shoqërisë civile dhe grupet e interesit të përfshira në angazhimin qytetar, rritjen e transparencës dhe fuqizimin e demokracisë vendore, por edhe në promovimin e barazisë gjinore, në nivel vendor.

Partnerët tanë monitoruan aktivitetet e kandidatëve politikë në fushatën zgjedhore me synim identifikimin e çdo incidenti të mundshëm të dhunës ndaj grave në politikë. Monitorimi u bë

---

<sup>16</sup> Faqja zyrtare: <https://popnetwork.al/>

nëpërmjet vëzhgimit të fushatave publike, takimeve të hapura, debatit politik, analizimit të retorikës politike, si dhe forumeve publike dhe ndërveprimeve të kandidatëve me votuesit.

Megjithatë, edhe përmes kësaj metode të monitorimit, nuk u zbuluan raste konkrete të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023. Ky rezultat tregon se në këto 12 bashki të vendit, incidentet e dhunës ndaj grave në politikë ishin të rralla ose të padenoncueshme në këtë periudhë.

Një arsye tjetër mund të jetë dhe mungesa e gjerë e ofertave politike nga partitë të kandidimit të grave në zgjedhjet vendore të 2023. Përgjatë monitorimit të Rrjetit POP aty ku rrjeti operon, vetëm 5 kandidatura ishin gra për ofertën politike zgjedhore, respektivisht në bashkitë Vau i Dejës, Durrës, Tiranë, Fier dhe Korçë; ku nëpërmjet monitorimit të POP vetëm znj. Emiriana Sako nga këto kandidatë u shpall fituese në bashkinë Durrës.<sup>17</sup>

## 6. Analizimi i monitorimit nga aktorë të tjerë

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” ka analizuar dhe ndjekur në mënyrë të vazhdueshme edhe angazhimin dhe monitorimin e aktorëve të tjerë të cilët kanë kontribuar në analizën e procesit zgjedhor dhe vlerësimin e dhunës ndaj grave në politikë. Këta aktorë përfshijnë:

- **Organizatave e monitorimit të zgjedhjeve:** Nëpërmjet raporteve të tyre, organizatat e monitorimit të zgjedhjeve kanë ofruar një perspektivë të gjerë mbi zhvillimet dhe incidentet në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023.
- **Autoritetet zgjedhore:** Informacionet zyrtare nga autoritetet zgjedhore, si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kanë qenë burime kyçe për analizën tonë. Përmes raporteve dhe të dhënave zyrtare, kemi pasur mundësinë të vlerësojmë përgjithësisht procesin zgjedhor dhe të identifikojmë ndonjë indikacion të dhunës ndaj grave në politikë.
- **Autoriteti i Mediave Audiovizive:** Kontributi i autoritetit të mediave audiovizive ka qenë i rëndësishëm në monitorimin e fushatave zgjedhore dhe ndërveprimeve politike. Duke i analizuar materialet e publikuara nga këto burime, kemi ndjekur zhvillimet në politikë dhe kemi vlerësuar nëse ka pasur ndonjë manifestim të dhunës ndaj grave.
- **Vëzhguesit e trajnuar:** Organizatat partnere të rrjetit POP - Përballja e Ofertave Politike kanë kontribuar në monitorimin e zgjedhjeve dhe identifikimin e rasteve të mundshme të dhunës ndaj grave në politikë. Përmes raporteve dhe vlerësimeve të tyre, kemi pasur një perspektivë të specializuar mbi ndikimin e dhunës në procesin zgjedhor.
- **Media:** Në përpjekjen për të vlerësuar dhunën ndaj grave në politikë, kemi pasur parasysh informacionet dhe raportimet e mediave lokale dhe kombëtare. Këto burime kanë qenë të rëndësishme për të dokumentuar dhe analizuar zhvillimet në politikë, përfshirë ndonjë indikacion të dhunës.
- **OSBE ODIHR:** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE ODIHR) ka zhvilluar monitorimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Përmes raporteve dhe vlerësimeve të tyre, kemi përfshirë perspektivën e tyre në analizën tonë të dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023.

---

<sup>17</sup> Faqe zyrtare: <https://popnetwork.al/>

- **Burime të hapura:** Përveç burimeve tradicionale të informacionit, kemi gjurmuar informacionin dhe raportimet në blogje dhe rrjete sociale. Përmes këtyre burimeve të hapura, kemi qenë në gjendje të identifikojmë opinionin publik dhe manifestimet e mundshme të dhunës ndaj grave në politikë.

Duke analizuar të dhënat dhe informacionet e ofruara nga këta aktorë të monitorimit të zgjedhjeve, u ofruan një panoramë më e plotë dhe e thelluar mbi fenomenin e dhunës ndaj grave në politikë në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023.

Gjatë monitorimit të zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023, OSBE ODIHR ka publikuar Deklaratën e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake<sup>18</sup>. Sipas kësaj deklarate, asnjë bashkëbisedues i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MZV) të OSBE ODIHR-it nuk ka shprehur shqetësime në lidhje me retorikën mizogjene, kërcënime apo gjuhën e urrejtjes drejtuar politikaneve, apo ngacmime online ndaj grave në kontekstin zgjedhor.

Ky rezultat i monitorimit është i rëndësishëm dhe i përgjueshëm, duke treguar se nëpërmjet këtij procesi zgjedhor nuk janë vërejtur shqetësime të veçanta në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë. Kjo gjetje i jep një aspekt pozitiv procesit zgjedhor dhe sugjeron se ndërjegjësimi dhe kujdesi ndaj çështjes së dhunës ndaj grave ka njohur progres, ndërsa ligjet dhe masat parandaluese kanë forcuar mjedisin politik në mënyrë që të parandalohet dhe ndëshkohet ky fenomen.

Bazuar në konkluzionet e OSBE ODIHR-it, ndërveprimet politike në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 kanë qenë në përgjithësi të larmishme dhe pa manifestime të dukshme të dhunës ndaj grave. Kjo nuk do të thotë se fenomeni i dhunës ndaj grave është eliminuar plotësisht, por tregon një përparim dhe një kujdes të rritur ndaj kësaj çështjeje nga faktorët politikë.

Në këtë përpjekje për të bërë një analizë të detajuar mbi dhunën ndaj grave në politikë në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023, GADC ka konsultuar në mënyrë të vazhdueshme Raportet Monitoruese të Autoritetit të Mediave Audiovizive, si institucioni në cilësinë e autoritetit rregullator që monitoron pasqyrimin e fushatës zgjedhore. Sipas raportit të monitorimit nga AMA të fushatës zgjedhore për periudhën 14 prill – 12 maj 2023, vetëm 7.6% e hapësirës kohore në të gjitha mediat me monitorim të përhershëm u është kushtuar kandidatëve gra<sup>19</sup>. Gjithashtu, po sipas AMA në fushatën për zgjedhjet vendore të 14 majit, gratë kishin vetëm 11% të protagonizmit në media, kundrejt burrave.<sup>20</sup>

Këto raporte ditore janë vlerësuar si një burim i rëndësishëm për të vëzhguar se si media pasqyron zhvillimet politike dhe ngjarjet në këto zgjedhje vendore. Gjatë analizës janë shqyrtuar me kujdes këto raporte për të identifikuar raste të mundshme të dhunës ndaj grave në politikë.

Megjithëse raportet monitoruese të medias kanë ofruar një pasqyrë të gjerë të zhvillimeve politike, nuk është raportuar asnjë rast konkret i dhunës ndaj grave në politikë në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023. Ky rezultat, përsëri, konfirmon trendin e mungesës së raportimeve të

---

<sup>18</sup> OSBE ODIHR Deklarata e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake

[https://www.osce.org/files/f/documents/3/c/543570\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/3/c/543570_0.pdf)

<sup>19</sup> Me transmetimet e drejtëpërdrejta që kanë lidhje me fushatën zgjedhore 14 prill – 12 maj 2023

[https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/VENDIMI\\_AMA\\_6-14-MAJ.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/VENDIMI_AMA_6-14-MAJ.pdf)

<sup>20</sup> Faqe zyrtare [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)

tilla në të gjitha aspektet e dhunës ndaj grave, duke përfshirë aspektet verbale, emocionale, apo forma tjera të dhunës. Gjithashtu mungesa e vizibilitetit në media kombëtare mund të ndikojë negativisht në nivelin e përfshirjes së grave në procesin zgjedhor dhe në perceptimin publik të tyre.

Ky rezultat është i rëndësishëm për të kuptuar se media, si një kanal komunikimi dhe informacioni, nuk ka raportuar raste konkrete të dhunës ndaj grave në politikë gjatë fushatës zgjedhore. Kjo mund të interpretohet si një shenjë e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të mediave për të promovuar një kulturë politike të shoqërisë së barabartë dhe të respektit ndaj të drejtave të njeriut.

Kjo analizë thekson edhe një herë se në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 ka pasur një nivel të ulët të dhunës ndaj grave gjatë fushatës zgjedhore dhe nuk është raportuar ose realisht nuk ka patur dhunë ndaj grave në politikë.

Kjo gjetje, së bashku me analizat e tjera të kryera, tregon se ka pasur një ndërgjegjësim dhe një përgjegjësi të rritur në mesin e aktorëve politikë, mediave, dhe publikut për të parandaluar dhe kundërshtuar dhunën ndaj grave në politikë. Kjo vëmendje e shtuar dhe angazhimi i tyre për një mjedis politik të barabartë dhe të respektueshëm për të gjitha gjinitë është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një shoqërie të drejtë dhe të barabartë.

Për të kuptuar më mirë kontekstin dhe për të siguruar që këto gjetje janë të plota dhe të hollësishme, duhet vazhduar me analizimin edhe të burimeve të tjera të monitorimit dhe të mbledhjen informacione të shtuara për të përcaktuar më tej përhapjen dhe natyrën e dhunës ndaj grave në politikë gjatë zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023.

Sipas Raportit “Analiza e Barazisë Gjinore në financimin e Partive Politike në Shqipëri”<sup>21</sup> publikuar në Mars 2023, konkludohet se: Nuk është arritur plotësisht transparencja në financimin politik dhe zgjedhor. Ka hapësirë për përmirësim të kuadrit ligjor dhe zbatimin e dispozitave që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien. Është e nevojshme rritja e kapaciteteve të partive politike për të respektuar parimet e statuteve të tyre për financimin politik, raportimin dhe transparencën.

Përgjatë fushatës zgjedhore është vënë re se një nga shkeljet më të përsëritura të partive politike lidhet me plotësimin e kuotave të grave pjesë së procesit zgjedhor, ku partitë politike e kanë më të lehtë të shkelin ligjin dhe të paguajnë gjoba për mosplotësimin e kuotave për rritjen e grave në listat partiake sesa anasjelltas. Deri më tani nuk ka mekanizma të qëndrueshëm financimi për forumet e grave apo programe trajnimi të synuara për gratë kandidatë që financohen drejtpërdrejt nga partia, as programe të tjera që synojnë të rrisin financimin dhe aftësitë e kandidatëve gra. Partitë politike në Shqipëri mund dhe duhet të bëjnë më shumë për t'i fuqizuar në mënyrë kuptimplotë gratë që janë tashmë në parti si dhe për të tërhequr gra të tjera, veçanërisht nga zonat rurale.<sup>22</sup>

---

<sup>21</sup> Raporti “Analiza e Barazisë Gjinore në financimin e Partive Politike në Shqipëri” autore Mirela Arqimandriti [https://gadc.org.al/media/files/upload/Barazia%20Gjinore%20ne%20Financimin%20e%20Partive%20Politike\\_Final.pdf](https://gadc.org.al/media/files/upload/Barazia%20Gjinore%20ne%20Financimin%20e%20Partive%20Politike_Final.pdf)

<sup>22</sup> Po aty.

## 7. Analiza e Gjetjeve Kryesore

Analiza e rasteve të dhunës ndaj grave në politikë gjatë fushatës zgjedhore ka treguar një mungesë të rasteve të raportuara të dhunës. Pavarësisht nga forma e dhunës, si verbale, emocionale, apo të tjera, nuk janë vërejtur raste të dukshme gjatë kësaj periudhe zgjedhore. Kjo mund të interpretohet në dy mënyra:

- Një interpretim i mundshëm është se mungesa e raportimeve mund të reflektojë një rritje të ndërgjegjësimit dhe një forcim të masave ligjore kundër dhunës ndaj grave në politikë.
- Një interpretim tjetër mund të jetë se gratë mund të kenë pasur frikë ose rezerva për të raportuar rastet e dhunës në politikë.

Ky konstatim tregon një aspekt pozitiv të procesit zgjedhor dhe paraqet një rezultat të favorshëm për të drejtat dhe sigurinë e grave në politikë.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky konstatim mund të ketë edhe një anë negative, e cila lidhet me faktin që disa gra mund të kenë ngurruar të raportojnë rastet e dhunës për shkak të frikës, duke zgjedhur heshtjen si opsion. Dhuna ndaj grave në politikë është një çështje delikate dhe shpeshherë gratë mund të përballen me pengesa, stigma dhe pasoja negative nëse vendosin të raportojnë rastet. Kjo frikë mund të bëjë që shumë raste të dhunës të mbeten të padokumentuara dhe të injorohen.

Për të marrë një panoramë të plotë në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë, është e nevojshme të përfshihen të gjitha perspektivat dhe të sigurohet një mjedis i sigurtë dhe inkurajues për gratë që të raportojnë rastet e dhunës. Kjo mund të arrihet nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit dhe përkrahjes së grave që janë të përfshira në politikë. Gjithashtu, duhet të ketë mekanizma të besueshëm dhe lehtësisht të menaxhueshëm për raportimin e rasteve të dhunës, duke garantuar anonimitetin dhe mbrojtjen e ofruar për gratë që vendosin të tregojnë historitë e tyre.

**Diskriminimi në përdorimin e mjeteve të fushatës dhe burimeve:** Në analizën e kryer, u identifikuan disa aspekte të diskriminimit në përdorimin e mjeteve të fushatës dhe burimeve që kanë ndikim në pjesëmarrjen e grave në politikë. Një nga sfidat kryesore është mungesa e financimit adekuat për fushatat e grave. Financimi i kufizuar i disponueshëm për kandidatet gra mund të krijojë një pengesë në përpjekjet e tyre për të paraqitur platformat dhe mesazhet e tyre në mënyrë efektive. Kandidatët burra, të mbështetur nga burime më të mëdha financiare, mund të kenë një avantazh të dukshëm në çështjen e vizibilitetit dhe përfshirjes në debatet publike. Një tjetër aspekt i diskriminimit është vizibiliteti në mediat kombëtare. Shpeshherë, raportimi i mediave kombëtare është i orientuar nga stereotipet gjinore dhe mbështetja e përfshirja e grave në politikë është e pamjaftueshme. Kjo i shkakton vështirësi grave të politikës për të fituar vizibilitetin e duhur dhe për të paraqitur agjendën e tyre politike në një mënyrë të barabartë. Edhe pse ka pasur pak ndryshim në këtë drejtim, ende vërehet një pabarazi në trajtimin e grave në mediat kombëtare, ku prezantimi dhe raportimi i tyre është i pakët dhe jo i barabartë me homologët e tyre burra. Kjo mungesë e vizibilitetit në media ndikon në një nivel të ulët të njohurisë së votuesve mbi kandidatet gra dhe ul iniciativën e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje.

Ky diskriminim në përdorimin e mjeteve të fushatës dhe burimeve parashtron nevojën për hapa të mëtejshëm për të adresuar këto probleme. Është e rëndësishme që institucionet zgjedhore, organet rregullatore, media dhe shoqëria civile të bashkëpunojnë për të siguruar financim të drejtë dhe të barabartë për kandidatet gra, për të garantuar prezantimin e tyre në media në mënyrë të barabartë dhe për të luftuar gjuhën urrejtëse dhe kërcënimet nëpërmjet ndërhyrjeve efektive.

**Problemet dhe sfidat e grave në pjesëmarrjen në zgjedhje:** Gjatë kësaj analize u identifikuan një sërë problemesh dhe sfidash me të cilat ballafaqohen gratë në pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje. Një ndër sfidat kryesore është mungesa e përfaqësimit të barabartë të grave në politikë, ku ato ende hasin pengesa dhe paragjykimet.



Mungesa e financimeve adekuate për fushatat zgjedhore të grave është një nga problemet kryesore. Shpeshherë gratë hasin vështirësi në sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për të promovuar platformën e tyre politike dhe për të arritur një vizibilitet të barabartë me konkurrentët e tyre burra. Ky faktor i diskriminimit financiar pengon pjesëmarrjen e barabartë të grave përgjatë procesit zgjedhor.

Përveç kësaj, gratë përballen me sfida të tjera si kulturat patriarkale, paragjykime të lidhura me rolin e tyre në politikë, dhe klimën e përgjithshme të diskriminimit gjinor. Këto sfida shpesh krijojnë pengesa psikologjike dhe emocionale për gratë që ndikojnë në vendimmarrjen e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për t'u angazhuar në politikë.

## 8. Konkluzione

Nëpërmjet analizës së zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 në Shqipëri në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë, është arritur në disa gjetje kryesore. E para, nuk janë identifikuar raste të dukshme të dhunës ndaj grave gjatë fushatës zgjedhore. Ky fakt tregon për një hap pozitiv drejt përmirësimit të klimës politike dhe parandalimit të dhunës ndaj grave në politikë por lë vend për të dyshuar se rastet e dhunës ndaj grave në politikë nuk raportohen. E dyta, janë identifikuar sfida dhe probleme të vazhdueshme për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe përfaqësimin e tyre të barabartë në politikë.

Në mënyrë që të sigurohet një pjesëmarrje e ndërgjegjshme, e barabartë dhe e lirë e grave në procesin zgjedhor, është e domosdoshme të ndërmerren veprime të menjëhershme. Autoritetet, aktorët politikë dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të bashkëpunojnë për të hartuar dhe zbatuar politika dhe ligje që parandalojnë dhe ndëshkojnë dhunën ndaj grave në politikë. Po ashtu, duhet të ndërmerren masa për të inkurajuar dhe përmirësuar pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor, përfshirë fonde publike për fushatat e grave dhe programe të ndërgjegjësimit dhe trajnimit për pjesëmarrjen aktive të grave në politikë.

Për të ardhur në një klimë politike ku të drejtat e grave në politikë respektohen në tërësi, është e rëndësishme të vazhdojë puna për adresimin e sfidave dhe problemeve të identifikuara në procesin zgjedhor. Përfaqësimi i barabartë i grave në politikë dhe parandalimi i dhunës dhe diskriminimit ndaj tyre duhet të jenë prioritet për institucionet zgjedhore, aktorët politikë dhe organizatat e shoqërisë civile. Vetëm nëpërmjet veprimeve të përbashkëta dhe angazhimit të gjithë palëve mund të ndërtohet një sistem politik ku gratë kanë mundësinë dhe sigurinë për t'u angazhuar në politikë dhe për të ndikuar në proceset vendimmarrëse në mënyrë të barabartë.

Kjo analizë tregon se:

- Në kontekstin zgjedhor, ka disa çështje kyçe që na bëjnë të reflektojmë mbi përfaqësimin dhe mungesën e dhunës ndaj grave në politikë. Për të filluar, edhe pse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind për të gjitha organet e administrimit zgjedhor, numri i grave në pozicionet vendimmarrëse mbetet i ulët. Në KQZ, vetëm tre nga 12 anëtarët janë femra, duke përfshirë edhe nënkomisionerin, ndërsa rreth 29 për qind e anëtarëve të KZAZ-së ishin femra, duke përfshirë vetëm 19 nga 92 kryetarët e komisioneve. Ky fakt tregon qëndrime të dobëta në ndërtimin e një përfaqësimi të barabartë gjinor në institucionet zgjedhore.
- Për më tepër, edhe pse Kodi Zgjedhor parashikon kuotën gjinore, numri i grave kandidatë për postet e kryetar bashkie ishte i ulët. Nga 144 kandidatë, vetëm 15 ishin gra. Kjo tregon se edhe në nivelin e kandidaturave, gratë janë të nënpërfaqësuara. Kështu, mungesa e pjesëmarrjes së grave në pozicionet vendimmarrëse në administratën zgjedhore është një sfidë për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore në politikë.

- Një aspekt tjetër i vëmendjes është mungesa e raportimeve për dhunën ndaj grave në politikë gjatë fushatës zgjedhore. Pavarësisht nga forma e dhunës, si verbale, emocionale ose të tjera, nuk janë vërejtur raste të dukshme gjatë kësaj periudhe zgjedhore. Megjithatë, është vërejtur një diskriminim në përdorimin e mjeteve të fushatës dhe burimeve. Financimi i pamjaftueshëm për fushatat e grave, mungesa e vizibilitetit në media lokale dhe kombëtare si dhe pengesat në aksesimin e burimeve janë disa prej sfidave që gratë hasin gjatë pjesëmarrjes në fushatën zgjedhore.
- Sipas monitorimit të GADC, si dhe bazuar edhe në Deklaratën e gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, nuk janë gjetur raste të retorikës mizogjene, kërcënimeve apo gjuhës së urrejtjes drejtuar politikaneve grave, as ngacmime online ndaj tyre në kontekstin zgjedhor. Ky fakt tregon se në aspektin e shprehjes së urrejtjes dhe dhunës verbale, situata ka qenë më e qetë dhe me më pak tensione gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, duhet të jemi të vetëdijshëm që mungesa e raportimeve të dhunës nuk do të thotë se dhuna ndaj grave në politikë nuk ekziston. Shumë faktorë, si frika, stigma dhe ndërlikimet procedurale, mund të pengojnë raportimin e rasteve të dhunës.

## 9. Rekomandime

Në kuadër të këtij monitorimi dhe raporti janë hartuar një sërë rekomandimesh të cilat do të përdoren për të advokuar ndryshimet përkatëse pranë partive politike shqiptare, anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, shoqërisë civile dhe gjithë aktorëve të interesuar.

### Për Kuvendin e Shqipërisë

- Të rishikohet legjislacioni dhe të ndërtohen mekanizmat efektivë për ndëshkimin e dhunës dhe sjelljeve diskriminuese ndaj grave në politikë. Autoritetet duhet të punojnë në hartimin e ligjeve të rrepta që të parandalojnë dhe ndëshkojnë veprimtarinë e dhunshme dhe shprehjen e gjuhës së urrejtjes në politikë. Sjelljet diskriminuese dhe të dhunshme duhet të parandalohen përmes forcimit të legjislacionit kundër dhunës ndaj grave e vazhata në politikë e vendimmarrje.
- Të krijohen mekanizma efektivë të cilët duhet të trajtojnë rastet e dhunës dhe diskriminimit ndaj grave në politikë. Këto mekanizma duhet të jenë të pavarura, transparente dhe të përfshijnë hetime të plotësueshme dhe ndëshkuese ndaj shkelësve.
- Kuadri ligjor duhet të adresojë shprehjen e gjuhës së urrejtjes dhe sjelljet e dhunshme në politikë. Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje për të monitoruar dhe ndëshkuar ata që përdorin gjuhë ofenduese, shpifëse dhe diskriminuese ndaj grave në politikë.
- Autoritetet duhet të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit të përfshira në luftën kundër dhunës ndaj grave në politikë. Këto organizata mund të ofrojnë ekspertizë dhe mbështetje për hartimin e politikave dhe masave efektive kundër dhunës dhe diskriminimit.
- Të sigurohet trajnimi i përbashkët për aktorët politikë dhe punonjësit e administratës zgjedhore në lidhje me parandalimin dhe ndalimin e dhunës ndaj grave. Trajnimi duhet të fokusohet në ndërgjegjësimin për rëndësinë e shanceve të barabarta dhe respektimit të të drejtave të grave në politikë. Trajnimi duhet të vendosë theksin në rëndësinë e barazisë gjinore dhe respektimit të të drejtave të grave në politikë. Ky trajnim duhet të trajtojë çështjet

e diskriminimit, shprehjes së gjuhës urrejtëse dhe sjelljes së dhunshme ndaj grave në politikë, duke promovuar një kulturë të respektit dhe të barazisë gjinore.

- Nëpërmes fushatave informuese dhe sensibilizuese, aktorët politikë dhe punonjësit e administratës zgjedhore duhet të informohen për rëndësinë e parandalimit dhe ndalimit të dhunës ndaj grave në politikë. Kjo mund të ndihmojë në ndërgjegjësimin e tyre dhe në përmirësimin e sjelljes së tyre në proceset zgjedhore.

### **Për partitë politike shqiptare**

- Duhet të hartohen politika dhe ligje specifike që rregullojnë raportimin e dhunës dhe diskriminimit ndaj grave në politikë. Këto politika dhe ligje duhet të përcaktojnë mekanizma të qartë dhe të thjeshtë për raportimin, si dhe të sigurojnë anonimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave të personave të përfshirë.
- Të përfshihen në statutet e partive nene të cilat dënojnë dhunën ndaj grave e vajzave në politikë e vendimmarrje.
- Të krijohen mekanizma të besueshëm dhe lehtësisht të menaxhueshëm për raportimin e dhunës apo diskriminimit në politikë. Ky raportim duhet të sigurojë anonimitet dhe privatësinë e situatës dhe të personave që raportojnë dhe duhet të ofrojë atyre mbështetje të nevojshme dhe ndihmë ligjore për të mbrojtur të drejtat e tyre.

### **Për organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e ndihmës ligjore.**

- Është e rëndësishme të informohen dhe të ndërgjegjësohen gratë në politikë për ekzistencën e dhunës dhe diskriminimit dhe se si duhet ta raportojnë atë. Fushatat informative dhe trajnimet mund të ndihmojnë në ngritjen e ndërgjegjësimin dhe në inkurajimin e grave që vuajnë dhunë ose diskriminim të raportojnë për përvojat e tyre.
- Është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e denoncuesve dhe dëshmitarëve të rasteve të dhunës dhe diskriminimit ndaj grave. Kjo mund të realizohet përmes masave të sigurisë dhe anonimitetit për denoncuesit, si dhe përmes ofrimit të mbështetjes dhe ndihmës ligjore për ta.
- Është e nevojshme të sigurohet qasja lehtësisht e arritshme dhe të ofrohet ndihma ligjore për gratë që vuajnë dhunë ose diskriminim në politikë. Kjo përfshin ofrimin e informacionit për të drejtat ligjore, ndihmën në hartimin e ankesave dhe ndjekjen e procedurave ligjore, falas, për të mbrojtur të drejtat e tyre.

### **Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor:**

- Të ndërmerren masa për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të grave në politikë. Kjo përfshin përmirësimin e mjedisit politik të përfaqësimit të barabartë të grave në listat zgjedhore dhe promovimin e tyre në pozicione vendimmarrëse.
- Të sigurohet një ambient i barabartë dhe i sigurtë për fushatat zgjedhore të grave. Kjo mund të realizohet përmes krijimit të fondeve publike për financimin e fushatave të grave dhe mbikëqyrjes së rregullave për përdorimin e burimeve dhe mjeteve të fushatave.
- Të ofrohen programe edukative dhe trajnime për të ndërgjegjësuar gratë të reja të cilat duan të futen në politikë. Këto programe duhet të përfshijnë edukimin mbi të drejtat e grave, aftësimin politik dhe zhvillimin e besimit në aftësitë e tyre.

## Rekomandime dhe sugjerime për të mbështetur gratë e interesuara të angazhohen në politikë:

- Të krijohet një kulturë politike ku gratë të inkurajohen dhe mbështeten që të angazhohen në politikë. Kjo përfshin eliminimin e stereotipave dhe paragjytimeve për rolin e grave në politikë dhe promovimin e aftësive dhe përvojës së tyre në këtë fushë.  
Për të realizuar këtë rekomandim mund të ndiqen disa sygjerime si më poshtë:
  - **Sensibilizim dhe informim:** Marrja e masave për të ngritur ndërgjegjësimin dhe informimin e grave të forumeve politike. Kjo mund të bëhet përmes fushatave të ndërgjegjësimin, workshop-eve, seminareve dhe materialeve informative për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në politike të grave.
  - **Trajnime dhe zhvillim aftësish:** Trajnime dhe programe të specializuara për të zhvilluar aftësitë politike të grave. Këto trajnime mund të përfshijnë tema si lidhshipi politik, strategjia e komunikimit, lobimi politik dhe menaxhimi i fushatave etj. Duke iu ofruar grave mekanizmat dhe mjediset e duhura për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë e tyre, do të rritet përgatitja e tyre për tu angazhuar në politikë.
  - **Përfaqësimi i barabartë:** Inkurajimi i partitve politike që të krijojnë kuota të rezervuara për gratë në listat e tyre zgjedhore. Kjo do të sigurojë një përfaqësim më të mirë të grave në politikë dhe do tu japë mundësi të barabarta. Gjithashtu, duhet të marrin parasysh edhe politikat inkurajuese, si mbështetja financiare për gratë që kandidojnë.
  - **Ndërtimi i rrjeteve:** Krijimi ose fuqizimi i rrjeteve dhe forumeve të grave politike. Këto rrjete dhe forume mund të ofrojnë një platformë për shkëmbim idesh, mbështetje dhe nxitje reciproke mes grave të interesuara për tu angazhuar në politikë. Ato mund të organizojnë takime periodike, diskutime, dhe të krijojnë hapësira ku gratë mund të ndajnë përvojat dhe sfidat e tyre politike.
  - **Promovimi i rolit të grave në politikë:** Krijimi i një komunikimi pozitiv dhe inkurajues për rolin dhe kontributin e grave në politikë. Ndarja e shembujve të suksesit të grave politike dhe ndikimi i tyre në politikën vendore, qendrore dhe ndërkombëtare.
  - **Përforsimi i legjislacionit dhe politikave pro-shanceve të barabarta:** Zhvillimi dhe përforsimi i legjislacionit dhe politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në politikë. Kjo mund të përfshijë masat për parandalimin e dhunës politike ndaj grave, mbështetjen financiare për organizatat e grave politike dhe hartimin e politikave për promovimin e barazisë gjinore.
  - **Të krijohen programe mentorimi dhe mbështetjeje për vajzat e reja të cilat ë dëshirojnë të angazhohen në politikë.** Këto programe duhet të ofrojnë udhëzim, këshilla dhe ndihmë praktike për t'i ndihmuar ato të zhvillojnë karrierën e tyre politike.
  - **Identifikimi i mentorëve të përshtatshëm:** Identifikimi i grave dhe burrave politikan të suksesshëm, me përvojë dhe ndikim në politikën vendore dhe qendrore. Këta mentorë duhet të jenë të motivuar dhe të angazhuar për të ndihmuar gratë e reja të zhvillojnë karrierën e tyre politike. Mund të konsiderohen personalitete politike, ish-kandidate të suksesshme, aktiviste të njohura dhe burime të tjera të afta për të ofruar udhëzim dhe këshilla.
  - **Krijimi i programeve strukturore:** Zhvillimi i programeve të mentorimit të mirëstrukturuara që ofrojnë udhëzime dhe ndihmë praktike për gratë e reja. Këto programe duhet të përfshijnë seanca të rregullta të takimeve me mentorët, diskutime për sfidat dhe mundësitë në politikë, trajnime të specializuara dhe

ndihmë me zhvillimin e aftësive kritike si lidershpi, komunikimi dhe menaxhimi i fushatave.

- **Partneritet me institucionet dhe organizatat relevante:** Krijimi i partneriteteve me institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare dhe institucione të tjera të interesuara në politikë. Këto partneritete mund të sigurojnë burime shtesë, ekspertizë etj.
- Të organizohen forume dhe takime ku gratë politikane të kenë mundësinë të shkëmbejnë përvoja, të diskutojnë sfidat dhe të ndajnë praktikën e mira për pjesëmarrjen e grave në politikë. Kjo do të krijojë një rrjet përkrahjeje dhe solidariteti mes grave në politikë. Për të realizuar këtë rekomandim mund të ndiqen disa sygjerrime për mënyrën e krijimit të kësaj kulture:
  - **Identifikimi i platformave dhe organizatave që punojnë për fuzimin e grave në politikë e vendimmarrje:** Identifikimi i organizatave, institucioneve apo iniciativave të interesuara për pjesëmarrjen e grave në politikë. Përfshirja e partive politike, organizatave joqeveritare, institucionet akademike, klube dhe grupe të interesuara për të bashkëpunuar.
  - **Planifikimi dhe organizimi i forumeve dhe takimeve:** Përgatitja e programeve të strukturuar për forumet dhe takimet. Identifikimi i temave që do të diskutohen, si roli i grave në politikë, sfidat dhe mundësitë, rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen politike dhe praktikën e mira nga gratë politikane të suksesshme.
  - **Financimi dhe promovimi i forumit:** Inkurajohet promovimi i gjerë i forumit apo takimit për të nxitur pjesëmarrjen e sa më shumë grave të interesuara. Përdorimi i mediave sociale, faqet e internetit, televizionet lokale apo/dhe ato kombëtare, ftesat personale dhe rrjetet e tjera për të informuar për eventin.
  - **Ndarja e përvojave dhe praktikave të mira:** Inkurajimi i grave politikane për të ndarë përvojat, sfidat dhe praktikën e mira për pjesëmarrjen e tyre në politikë.

## 10. Referenca

- Autoriteti i Mediave Audiovizive [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)
- Arqimandriti, M. (mars 2023). Arritja e Barazisë Gjimore në Financimin e Partive Politike në Shqipëri. Westminster Foundation for Democracy. Marrë nga [https://gadc.org.al/media/files/upload/Barazia%20Gjinore%20ne%20Financimin%20e%20Partive%20Politike\\_Final.pdf](https://gadc.org.al/media/files/upload/Barazia%20Gjinore%20ne%20Financimin%20e%20Partive%20Politike_Final.pdf)
- BIRN. (n.d.). Zgjedhje 2023: Live blog. Reporter.al. Marrë nga <https://www.reporter.al/2023/05/14/zgjedhje-2023-live-blog/>
- Faqja zyrtare e Platformës për Denoncimin e Dhunës ndaj Grave në Politikë: <https://stopvawp.al/>
- Faqe zyrtare e Rrjetit POP Përballja e Ofertave Politike <https://popnetwork.al/>
- Faqja Zyrtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (2023). Marrë nga <https://iemis.kqz.gov.al/results2023/results2023.htm>
- Faqe zyrtare Statcounter GlobalStats <https://gs.statcounter.com/social-media-stats/all/albania>
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë: [Kodi Penal-1.pdf \(drejtesia.gov.al\)](http://drejtesia.gov.al/Kodi_Penal-1.pdf)
- Ligji Nr. 10 221 datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (ndryshuar me ligjin nr.124/2020), neni 9
- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjimore në Shoqëri”

- Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve. (2023) OSBE ODIHR. Deklarata e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake. Marrë nga [https://www.osce.org/files/f/documents/3/c/543570\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/3/c/543570_0.pdf)
- Monitorimet e Fushatës Zgjedhore AMA [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/VENDIMI\\_AMA\\_6-14-MAJ.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/VENDIMI_AMA_6-14-MAJ.pdf)
- Portali Balkan Web: <https://www.balkanweb.com/igli-cara-mund-te-jete-djali-i-mire-por-nuk-do-bejme-krushqi-rama-nga-durresi-po-te-jete-per-pastrues-merr-nje-grua/>
- Pyetësor Online: <https://stopvawp.al/formulari-online/>
- Televizioni A2: <https://www.youtube.com/watch?v=wme2UpWQWEk>